



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1250/3 Prot

Tiranë, më 12/1 /2016

Lënda: Jepet mendim mbi Marrëveshjen e Bashkëpunimit “Për përcaktimin e bashkëpunimit midis Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve të Integruara (ADISA) dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP)”

Drejtuar: **Z. Albenc KONI**
Drejtor i Përgjithshëm
Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)

Për dijeni: **Z. Ilirjan MUHO**
Kryeregjistrues
Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP)

Tiranë

Z. Koni,

Në përgjigje të shkresës tuaj Nr. 576/2 Prot, datë 23.12.2015, në marrëveshjen e bashkëpunimit “Për përcaktimin e bashkëpunimit midis Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP)”, referuar edhe terminologjisë ligjore të përdorur në të, konstatojmë se kemi të bëjmë me përhapje të të dhënave personale, nëpërmjet bazës së të dhënave të ZQRPP, nga kjo e fundit në adresë të ADISA. Përhapja e të dhënave personale legjitimohet nëpërmjet urdhrave të përbashkët të ADISA dhe ZQRPP dhe Marrëveshjes dypalëshe, në zbatim edhe të nenit 6 të ligjit nr. 9887/2008.

Nga përmbajtja e marrëveshjes, dokument tashmë i miratuar, konstatohet se në të nuk janë parashikuar kategoritë e të dhënave personale që aksesohen, niveli i aksesit si dhe mënyra e aksesit gjatë përpunimit të të dhënave.

Gjithashtu, përveç sa është parashikuar në këtë dokument, sugjerojmë që gjatë zbatimit të saj, përpunimi/shkëmbimi i të dhënave personale të kryhet në përputhje me *Udhëzimin nr. 21, datë 24.09.2012 të Komisionerit “Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”*.

Njëkohësisht, është e rëndësishme që çdo subjekt i të dhënave, të cilit i përpunohen të dhënat personale, të informohet paraprakisht mbi qëllimin e përpunimit dhe përhapjes, mënyrën e përpunimit, të drejtat që gëzojnë në cilësinë e subjektit të të dhënave, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat konkrete të sigurisë teknike dhe fizike, bazuar në nenin 18 të ligjit. *Mënyra e kryerjes së informimit duhet të jetë e provueshme.*

Së fundi, sjellim në vëmendjen tuaj detyrimin për të hartuar rregullore të brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale përfshirë në to edhe masat e sigurisë si dhe hartimin e politikës së sigurisë së informacionit. *(Referojuni për këtë nenit 27 të ligjit nr.9887/2008 si dhe Udhëzimit të Komisionerit të sipër përmendur)*

Me përshtatjen e këtyre konstatimeve, sugjerimeve dhe detyrimeve, kjo marrëveshje vlerësohet e hartuar konform kërkesave të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

